



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**“ISA BOLETINI”**

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; Tel: +383-28535725/535727

Nr. Prot. \_\_\_\_\_ Dt 23.11.2020

Në mbështetje të nenit 7 të Rregullores për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, Komisioni Qendror i Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në UMIB (më tutje: KQSCV) në mbledhjen e vet të mbajtur me datën 23.11.2020 miratoi:

**RREGULLORE MBI PUNËN E KQSCV-së**

**Neni 1**

Më këtë Rregullore të punës (në tekstin e mëtejme Rregullore) të KQSCV-së rregullohet procedura në punën e KQSCV-së duke përfshirë kuorumin, mbledhjet, marrjen e vendimeve dhe procedurat tjera.

**Neni 2**

KQSCV është organ këshillëdhënës i Senatit. Kompetencat e tij janë: të hartojë udhëzuesin e aktiviteteve të vlerësimit të sigurimit të cilësisë, të hartojë instrumentet për vlerësim kualitativ dhe kuantitativ, të hartojë dhe shqyrtojë raportet e vlerësimit/vetëvlerësimit, të shqyrtojë raportet e vetëvlerësimit për akreditim institucional dhe të programeve, të shqyrtojë raportet e vetëvlerësimit për riakreditim institucional dhe të programeve në lidhje me nivelin e adresimit të çështjeve të ngritura nga AKA, të miratojnë anëtarët e grupeve punuese për realizimin e vlerësimeve sipas nevojës si dhe të udhëheqë procesin e publikimit të raporteve vlerësuese.

**Neni 3**

1. KQSCV ka nëntë (9) anëtarë, me këtë përbërje:
  - Prorektori për cilësi (ex-officio);
  - Zyrtari nga zyra për zhvillim akademik;
  - Deri në 6 përfaqësues të personelit akademik nga njësitë e ndryshme akademike;
  - 1 përfaqësues i studenteve.
2. Në mbledhjet e KQSCV-së, sipas nevojës, mund të ftohen edhe anëtarë tjerë të cilët përfaqësojnë subjekte të ndryshme brenda UMIB-it dhe jashtë tij, që lidhen me çështjen e shtruar për rend të ditës.

3. Kryetari i KQSCV-së ex-officio është Prorektori për cilësi i cili edhe udhëheq me mbledhjet dhe i thërret ato.
4. KQSCV mund të zgjedhë në radhët e tij një zëvendëskryesues/e, i cili do të thërret mbledhjet dhe do të udhëheq ato në mungëse të kryetarit ose me autorizimin e tij/saj, me mandat një (1) vjeçar.

#### **Neni 4**

1. KQSCV-ja mbanë mbledhje të rregullta dy herë në muaj.
2. KQSCV mund të mbanë edhe mbledhje më të shpeshta të jashtëzakonshme, nëse paraqitet nevoja.
3. Mbledhjet e KQSCV-së janë të mbyllura për publik.

#### **Neni 5**

1. KQSCV mund të mbajë mbledhje nëse në të marrin pjesë së paku pesë (5) anëtarë të tij.
2. KQSCV-ja merr vendime dhe rekomandime me shumicën e votave të anëtarëve të përgjithshëm të tij.
3. Votimi gjatë marrjes së vendimit dhe rekomandimit është i hapur, me ngritjen e dorës.
4. Çdo anëtar i KQSCV-së pavarësisht nga vendimi i marr, mundet me e nda mendimin e vet mirëpo është i detyruar që në formë të shkruar t'ia dorëzoj kryetarit.

#### **Neni 6**

1. Mbledhjet e Rregullta të KQSCV-së thirren nga ana e Kryetarit të tij, jo më vonë se 48 orë para mbajtjes së saj, me gjithë rendin e ditës.
2. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren nëse për këtë pajtohen së paku 1/3 e anëtarëve të KQSCV-së, jo më vonë sesa 24 orë para mbledhjes.
3. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren edhe nga vet kryetari i KQSCV-së, nëse ai/ajo vlerëson së KQSCV-ja duhet të mblidhet për një çështje urgjente, jo më vonë sesa 12 orë para mbledhjes.
4. Mbledhjen e udhëheq Kryetari i KQSCV-së apo Zëvendëskryesuesi, përjashtimisht kur mungojnë që të dy, anëtarët e pranishëm votojnë që dikush tjetër të jetë kryesues për atë mbledhje.
5. Për cdo mbledhje, KQSCV-ja mbanë procesverbal, të cilin pas mbledhjes e ndanë me të gjithë anëtarët e tij/saj, dhe Kryetari i KQSCV-së e ruan atë në dosjen e tij/saj.

#### **Neni 7**

1. Përfundimisht për kompetencat ekskluzive të KQSCV-së, vendimet dhe rekomandimet e KQSCV-së i dërgohen Senatit të UMIB.
2. Vendimet dhe rekomandimet e KQSCV-së ruhen në arkivin e Universitetit dhe në zyrën e Kryetarit të tij.

#### **Neni 8**

Në punën e vet KQSCV-ja, duhet t'i përmbahet në përpikëri dispozitave të Rregullores për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Statutit dhe akteve tjera të brendshme të Universitetit, si dhe dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës.

#### **Neni 9**

1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Kryetari i KQSCV-së.
2. Interpretimin e kësaj Rregulloreje e jep KQSCV-ja.

#### **Neni 10**

Rregullorja miratohet nëse për të votojnë 2/3 e anëtarëve të KQSCV-së, dhe ndryshohet në të njëjtën procedurë.

23 Nëntor 2020

Kryetari i KQSCV-së

